



No.6 prot
Dt. 13/02/2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 5, datë 10.02.2026

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË PIJSHËM (SISTEME TË
FURNIZIMIT ME UJË TË POPULLATËS), TË SHOQËRISË
“AGJENCIA KOMBËTARE UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE (AKUK)”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi uJOR, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi uJOR nëntokësor për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës), të subjektit "AKUK", me vendndodhje: Fshati Pistull, Bashkia Vau Dejës.

2. Treguesit paraparak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH):

X=466053; Y=4648870; Z=12 m.m.n.d

Qëllimi i përdorimit të ujit: Për furnizimin me ujë të popullatës.

Prurja e ujit të kërkuar: Q=5 l/s


Qmes= 5 l/s

3. Të merren masat përkatëse për sigurimin e zonës së mbrojtjes sanitare të pus-shpimit.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

KRYETARI I KBL DRIN-BUNË



HOLTA DUDA